REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 131/17
Data/Datum 16.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr. 131/17

PANELI SHQYRTUES, i emëruar në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr.04/L-237, me ligjin nr.05/L-068 dhe me ligjin 05/L-92, në përbërje prej z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina – referues, z. Tefik Sylejmani – anetar, duke vendosur sipas ankesës së OE NPT **"Euroditi"** nga Prishtina, kundër autoritetit traktues/ **Korporata Energjetike e Kosovës**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me rreshira kationike dhe anionike"**, me nr. të Prokurimit:KEKO **16 428 121**, me dt. **13.06.2017**, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, ankesa e operatorit ekonomik: NPT **"Euroditi"** nga Prishtina, me nr. **131/17**, parashtruar kundër autoritetit kontraktues **"Korporata Energjetike e Kosovës"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me rreshira kationike dhe anionike"**, me nr. të Prokurimit:KEKO **16 428 121**, si e bazuar pjeserisht.

II. **Anulohet,** vendimi, i Autoritetit Kontraktues / **Korporata Energjetike e Kosovës**, rekomandimi, për dhënje të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me rreshira kationike dhe anionike"**, me nr. të Prokurimit:KEKO **16 428 121**, si i pa bazuar.

III. **Obligohet,** Autoritetit Kontraktues / **Korporata Energjetike e Kosovës"**, që aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me rreshira kationike dhe anionike"**, me nr. të Prokurimit:KEKO **16 428 121,** ti kthej në **ri vlerësim.**

IV. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit

Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues NPT"Euroditi, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, megjithatë obligohet i njejti që në afat prej më së largu gjashtëdhjetë (60) ditësh të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve - sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik NPT "Euroditi", me seli në Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: **04.05.2017**, me Nr. **131/17**, kundër rekomandimit për dhënje të kontratës, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së ne fuqi , siç janë:

- Neni – 1, 4, 8, 49, 64 dhe 65 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së ne fuqi, ka autorizuar ekspertet e OSHP se, për të shqyrtuar pretendimet ankimore të perfshira ne ankese, të OE NPT "Euroditi" – Prishtine . Te njëjti ekspert në raportin e datës: 29.05.2017, kanë sqaruar – trajtuar pretendimet e përfshira ne ankesë, rrjedhimisht i kanë propozuar panelit shqyrtues që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri vlerësim, ndërsa ankesa të aprovohet si e bazuar pjesërisht.

OE NPT "Euroditi", përmes parashtresës me shkrim të datës 30.05.2017 njofton panelin shqyrtues se të njëjtit pajtohen pjeserisht me mendimin e eksperteve te OSHP-së

AK "Korporata energjetike e Kosoves", po ashtu përmes parashtresës me shkrim të datës 01.06.2017, njofton panelin shqyrtues se të njëjtit nuk pajtohen me mendimin e eksperteve të OSHP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 26 të rregullores së punës se OSHP-së nr. 01/2017, vendosi që seancën ta mbaj pa prezencën e palëve, ku ishin prezent antarët e panelit shqyrtues si dhe eksperti shqyrtues, me ç'rast, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit, i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i eksperteve te OSHP se, raporti i vlerësimit, rrjedhimisht eksperti shqyrtues deklaroj se të gjitha pretendimet ankimore dhe përgjigjet në pikat ankimore i gjeni ne raport te shqyrtuara nga ekspeti teknik.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në provat shkresore konstatoi se komisioni i vlerësimit të ofertave ka rekomanduar për dhënje të kontrates operatorin ekonomik i cili nuk i ploteson në tërësi specifikacionet teknike të detyrueshme siq janë kerkuar nga AK, gjegjesisht të dhënat e përshkruara në katalog rezulton që nuk korespodojnë me të dhënat

a katalogut të publikuar ne uebin e prodhuesit, të gjeturat e ekspertit teknik, për rreshirat si "FA301FB, FA125CL-MB", të përshkruara në katalogun e prezantuar nuk gjinden në katalogun e prodhuesit përmes të cilit OE i rekomaduar ka ofertuar.

Prandaj paneli shqyrtues konstatoi se AK, sipas nenit 72, të LPP-së duhet të kërkoj sqarime shtesë dhe të argumentoj nëse prodhuesi "Felite Resin Technology" Co.ltd, i prodhon apo jo specifikacionet siq janë paraparë nga AK në dosje të tenderit.

KRYETARI I PANELIT SHQYRTUES

z. Nuhi Paçarizi

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur

nuk mundë të ushtron ankesë,

për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,

pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë

kërkesëpadi në Departamentin për çështje administrativ

pranë Gjykatës Themelore.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. AK – "Korporata Energjetike e Kosovës"
2. OE: NPT "Euroditi" – Prishtinë
3. Arhivës së OSHP-së.